BANKA E SHQIPËRISË

BULETINI ZYRTAR

vëllimi 13 numër 8 shtator 2011

Data e botimit 12.10.2011

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 31.08.2011 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes". 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 60, datë 31.08.2011 "Shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, kushtuar Nënë Terezës, në vitin 2012". 6
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 14.09.2011 "Për miratimin e rregullores "Për administrimin e rrezikut të kredisë"". 8
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 63, datë 14.09.2011 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"". 28
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 67, datë 14.09.2011 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Emisionit të Bankës së Shqipërisë"". 30
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 68, datë 29.09.2011 "Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes". 31

7. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, Vëllimi 13, Numër 1, Janar 2011 32
8. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, Vëllimi 13, Numër 2, Shkurt 2011 32
9. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, Vëllimi 13, Numër 3, Mars 2011 32
10. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, Vëllimi 13, Numër 4, Prill 2011 33
11. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, Vëllimi 13, Numër 5, Maj 2011 33
12. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, Vëllimi 13, Numër 6, Qershor 2011 34
12. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, Vëllimi 13, Numër 7, Korrik 2011 34

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 59, datë 31.08.2011

PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLTA TË RIBLERJES

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 5,25 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (repo dhe repo të anasjellta).

2. Ngarkohen Departamenti i Politikës Monetare dhe Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI — KRYETARI

YLLI MEMISHA — ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 60, datë 31.08.2011

PËR
SHTYPJEN E MONEDHAVE PËR QËLLIME NUMIZMATIKE,
KUSHTUAR NËNË TEREZËS, NË VITIN 2012

Në bazë dhe për zbatim të pikës 3 të nenit 33, të pikës 2 të nenit 39 dhe gërmës "d" të nenit 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; të pikës 3.1.1 dhe 3.1.2 të nenit 3 të udhëzimit "Mbi procedurat e shtypjes, rishtypjes dhe të emetimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike nga Banka e Shqipërisë" miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.36, datë 19.05.2005, si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë shtypjen për vitin 2012, të monedhave metalike për qëllime numizmatike, pa kurs ligjor, kushtuar Nënë Terezës, me të dhënat teknike si më poshtë:

Vlera emërore	Materiali, pastërtia dhe ngjyra e monedhave	Pesha	Diametri	Forma	Tirazhi gjithsej (në copë)	Nga kjo, për fondin numizmatik të paprekur të Bankës së Shqipërisë
200 Lekë	900/1000 Au	15.50 gr	25.45 mm	E dhëmbëzuar	1,000	100

a. Trajtimi i tematikës për monedhat e mësipërme të jetë i lirë, duke respektuar:
   i. në pamjen kryesore të kenë të shkruar vlerën; dhe

   ii. në pamjen e pasme të kenë të shkruar "Shqipëri–Albania 2012".

2. Përzgjedhja e vizatimeve, procedurave të konkurimit, si dhe kriteret e vlerësimit të vizatimeve të monedhave, të përcaktuara në pikën

1 të këtij vendimi, do të bëhen nga një komision i ngritur për këtë qëllim me urdhër të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI	KRYETARI
YLLI MEMISHA	ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 62, datë 14.09.2011

PËR
PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
"PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të neneve 57, 58, 61 dhe 68 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për administrimin e rrezikut të kredisë" dhe anekset e saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja "Për administrimin e rrezikut të kredisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 52, datë 14.07.2004, e ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI — KRYETARI

YLLI MEMISHA — ARDIAN FULLANI

RREGULLORE

"PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË NGA BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA"

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është:

a) përcaktimi i rregullave për administrimin e rrezikut të kredisë në veprimtarinë e bankave dhe degëve të bankave të huaja; dhe
b) përcaktimi i kritereve për vlerësimin e rrezikut dhe klasifikimin e kredive dhe aktiveve të tjera, si dhe llogaritjen e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga zhvlerësimi i tyre.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
b) neneve 57, 58, 61 dhe 68 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i cili këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet "ligji për bankat".

Neni 3
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, të cilat këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhen me termin e përbashkët "banka".

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin për bankat.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) "aktive të tjera" – janë aktivet financiare brenda dhe jashtë bilancit (duke përjashtuar kreditë), të cilat sipas standardeve kontabël, mbahen me koston e amortizuar;
b) "standardet kontabël" – janë standardet kontabël të hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare, të cilat sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, zbatohen nga bankat për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare;
c) "kredimarrës i ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit" – është kredimarrësi që përfiton kredi në valutë (monedhë të huaj) dhe/ose të indeksuar në valutë (monedhë të huaj) nga banka, dhe plotëson kriteret e mëposhtme:

i. të ardhurat e tij në origjinë gjenerohen në monedhë vendase ose në një monedhë të ndryshme nga monedha e përfitimit të kredisë,
ii. të ardhurat e tij në valutë (monedhë të huaj) mbulojnë më pak se 80% (tetëdhjetë për qind) të këstit të kredisë ose të kredisë në total (kryegjë dhe interes, në varësi të periudhës së llogaritjes) dhe detyrimeve të tjera në monedhë të huaj ose të indeksuara në valutë,
iii. nuk është i mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit nëpërmjet një produkti derivativ (instrumente derivative), që përdoret për këtë qëllim dhe që ofron kushte të përshtatshme mbrojtjeje.

d) "*stress-testing*" – është teknikë e administrimit të rrezikut të kredisë e përdorur për të vlerësuar ndikimin e ndryshimit të mundshëm të një ose më shumë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm mbi qëndrueshmërinë financiare të bankës;
e) "ristrukturimi i kredisë" – është lehtësimi/et që banka bën për kredimarrësin/it për shkak të vështirësive financiare të tyre të shkaktuara nga arsye ekonomike ose ligjore, të cilat nuk bëhen nga banka në asnjë rast tjetër dhe përfshijnë në përgjithësi:

i. lehtësimet e bëra në kushtet e kredisë nëpërmjet ndryshimit të një ose disa kushteve të kontratës (duke përfshirë ndryshimin e produktit dhe kapitalizimin e interesit), të cilat lidhen kryesisht me afatin, kryegjënë dhe normën e interesit,
ii. marrjen (përdorimin) e kolateralit apo pasurive të tjera për shlyerjen e pjesshme të kredisë,
iii. zëvendësimin e kredimarrësit fillestar ose përfshirjen e një kredimarrësi shtesë;

f) "vështirësi financiare të kredimarrësit" – janë përkeqësimet e gjendjes financiare të kredimarrësit, të cilat mund të sjellin vonesa në pagesat e kredisë ose klasifikimin e kredisë si kredi me probleme;
g) "kredi me probleme" – janë kreditë e klasifikuara në tre kategoritë e fundit të klasifikimit të kredive. Shuma bruto (kryegjë + interes)

e tyre përbën totalin e kredive me probleme;

h) "kapitalizimi i interesit" – është procesi përmes të cilit interesi i përllogaritur i shtohet kryegjësë;

i) "zbutja e rrezikut të kredisë" – është një teknikë e përdorur nga banka për të zvogëluar rrezikun e kredisë/ve të saj, nëpërmjet përdorimit të një garancie ose kolaterali;

j) "kolateral" – është aktivi që përdoret për të siguruar ekzekutimin e detyrimit ndaj bankës, në rastin kur kredimarrësi nuk paguan kredinë sipas kushteve dhe afateve të kontratës;

k) "garanci" – është angazhimi, i shprehur në mënyrë të shkruar nga një palë e tretë, për të paguar kredinë brenda një afati të caktuar, në rastin kur kredimarrësi nuk paguan sipas kushteve dhe afateve të kontratës;

l) "maturitet i mbrojtjes së kredisë" – është koha deri në datën më të afërt në të cilën marrëveshja e garancisë ose lënia si kolateral mund të përfundojë;

m) "vlerësues i pavarur" – është personi, i pajisur me licencën përkatëse ose certifikatën për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, i cili është i pavarur nga procesi i vendimmarrjes në dhënien e kredisë;

n) "plani i emergjencës" - është një dokument i hartuar nga banka, në të cilin pasqyrohen rregullat dhe procedurat që duhen zbatuar në kushte jo të zakonshme.

KREU II
KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË

Neni 5
Sistemi i administrimit të rrezikut të kredisë

1. Bankat krijojnë dhe zhvillojnë sistemin për administrimin e rrezikut të kredisë, të përshtatshëm me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarive të tyre financiare.

2. Sistemi i administrimit të rrezikut të kredisë është tërësia e politikave, procedurave, rregullave dhe strukturave të bankës, që shërbejnë për administrimin e rrezikut të kredisë.

3. Sistemi i administrimit të rrezikut të kredisë duhet të sigurojë në vazhdimësi vlerësimin në kohë të cilësisë së kredive dhe aktiveve të tjera, duke përcaktuar njëkohësisht fondet rezervë për mbulimin e humbjeve të lidhura me këtë lloj rreziku.

Neni 6
Struktura organizative

1. Banka krijon një strukturë të përshtatshme organizative për

administrimin e rrezikut të kredisë, duke përcaktuar qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese.

2. Banka siguron që funksioni i shitjes të kredive, të jetë i ndarë qartë nga pikëpamja organizative dhe operacionale, nga funksionet mbështetëse operacionale dhe ato të kontrollit të rrezikut të kredisë, deri në nivelet më të larta drejtuese.

3. Banka siguron strukturat e duhura për vlerësimin, matjen dhe kontrollin e rrezikut të kredisë, lidhur me përqendrimin sipas sektorëve, sipas gjeografisë/vendeve, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë etj.

Neni 7
Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues i bankës ose organi kompetent i bankës mëmë për degën e bankës së huaj, për qëllime të administrimit të rrezikut të kredisë, është përgjegjës për:

a) miratimin e strategjisë dhe politikave për administrimin e rrezikut të kredisë, si dhe mbikëqyrjen (monitorimin) e zbatimit të tyre;
b) shqyrtimin e përshtatshmërisë së strategjisë dhe politikave të zbatuara, të paktën çdo vit, si dhe në çdo rast që paraqiten zhvillime të rëndësishme që ndikojnë në veprimtarinë e bankës;
c) monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit të kontrollit të brendshëm, si pjesë përbërëse e sistemit të administrimit të rrezikut të kredisë;
d) miratimin dhe shqyrtimin (rishikimin) e rregullt të kufijve të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë;
e) shqyrtimin dhe analizën e raporteve të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë dhe monitorimin e veprimeve të ndërmarra për administrimin e rrezikut të kredisë;
f) shqyrtimin e rezultateve nga *stress test*-et, të paktën çdo 6 (gjashtë) muaj, me qëllim:

i. përmirësimin e strategjive dhe politikave të administrimit të rrezikut të kredisë,
ii. hartimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullativ të nevojshëm për zgjidhjen e çështjeve kryesore lidhur me ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë,
iii. parashikimin në kohën e duhur të kërkesave për rritjen e kapitalit dhe identifikimin e rrugëve më efektive për vënien në dispozicion të tij,
iv. zhvillimin e planeve efektive të emergjencës;

g) përcaktimin e përjashtimeve të mundshme nga kufijtë e vendosur të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë dhe delegimin e përgjegjësive për marrjen e vendimeve për zbatimin e këtyre përjashtimeve;

h) rishikimin e përshtatshmërisë së strukturave dhe adresimin e mosfunksionimit të tyre ose të përshtatjes me situatat e reja të paraqitura.

2. Këshilli drejtues siguron që sistemi për administrimin e rrezikut të kredisë është subjekt i një procesi efektiv dhe gjithëpërfshirës kontrolli të brendshëm.

Neni 8
Përgjegjësitë e Drejtorisë

1. Drejtoria e bankës është përgjegjëse për zbatimin e strategjisë dhe politikave për administrimin e rrezikut të kredisë, të miratuara nga Këshilli Drejtues ose nga organi përkatës i bankës mëmë.

2. Drejtoria e bankës, në kuadër të administrimit të rrezikut të kredisë është përgjegjëse për:

a) detajimin dhe zbatimin e procedurave për administrimin e rrezikut të kredisë të përshtatshme dhe në përputhje me politikat e miratuara nga Këshilli Drejtues ose organi përkatës i bankës mëmë;
b) krijimin e një sistemi efektiv të matjes, monitorimit, kontrollit dhe raportimit të rrezikut të kredisë, sipas llojit të ekspozimit;
c) ndërtimin e një sistemi të përshtatshëm raportimi përpara Këshillit Drejtues ose organit përkatës të bankës mëmë, mbi shkeljet e kufijve të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë;
d) krijimin e procedurave për matjen e efekteve që produktet e reja mund të kenë në ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë, si dhe monitorimin e detyrimeve dhe ekspozimeve të mundshme, bazuar në aktivitetet jashtë bilancit të bankës, duke përfshirë edhe ekspozimin ndaj rrezikut të kundërpartisë.

Neni 9
Aktet e brendshme

1. Bankat hartojnë strategjinë, politikat, procedurat dhe rregullat e brendshme për monitorimin dhe kontrollin në vazhdimësi të cilësisë së portofolit të kredisë dhe të aktiveve të tjera.

2. Aktet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni përmbajnë/ përfshijnë të paktën:

a) strategjinë e kreditimit sipas periudhave, duke përfshirë objektiva realiste në lidhje me zgjerimin e portofolit të kredisë, përbërjen e tij sipas sektorëve, sipas gjeografisë/vendeve, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë etj.;
b) politikat e normave të interesit, të afateve, të shlyerjeve dhe të madhësisë e të llojit të kredive;

c) rregullat dhe kriteret e vendosura për njohjen dhe analizën financiare të kredimarrësit dhe/ose të garantuesit të kredisë;
d) procedurat për dokumentacionin e nevojshëm që duhet plotësuar për dhënien e kredive, si edhe për miratimin e kredisë, sipas hierarkisë së strukturave;
e) politikat e administrimit të rrezikut për të gjithë portofolin dhe për çdo klient në veçanti, kufijtë e kredisë sipas llojeve të kredimarrësve, sipas sektorëve, monitorimin sipas objektit dhe llojit të kredisë, etj.;
f) metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të cilësisë së kredive dhe të krijimit të fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga zhvlerësimi i kredive;
g) metodologjinë për vlerësimin, matjen dhe kontrollin e rrezikut të kredisë, lidhur me përqendrimin sipas sektorëve, sipas gjeografisë/vendeve, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë etj.;
h) kriteret për ristrukturimin e kredive;
i) procedurat për vlerësimin e cilësisë së aktiveve të tjera dhe për llogaritjen e fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga zhvlerësimi i këtyre aktiveve;
j) procedurën për verifikimin e vlerësimit të kolateralit "pasuri e paluajtshme", të kryer nga një vlerësues i pavarur;
k) procedurat për monitorimin dhe vlerësimin periodik të kolateralit financiar;
l) procedurat për monitorimin periodik të garancive.

3. Bankat regjistrojnë dhe ruajnë të gjithë dokumentacionin përkatës për kreditë dhe aktivet e tjera.

Neni 10
Stress testing

1. Bankat, nëpërmjet zhvillimit të *stress test*-eve, vlerësojnë në vazhdimësi dhe në mënyrë të mjaftueshme ekspozimin e tyre ndaj rrezikut të kredisë, duke marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme në të ardhmen të faktorëve të rrezikut që ndikojnë në cilësinë e portofolit të kredive dhe gjendjen financiare të bankës, të materializuara në të ardhurat neto dhe në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

2. Periodiciteti me të cilin bankat kryejnë *stress test*-et, si dhe raportimi i rezultateve në strukturat drejtuese, përcaktohet prej tyre në përputhje me madhësinë e veprimtarisë, ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë dhe peshën e tyre në sistemin bankar, me kusht që ky periodicitet të mos jetë më pak se 2 (dy) herë në vit. Banka e Shqipërisë mund t'i kërkojë në çdo rast bankës kryerjen e *stress test*-eve në periudha më të shpeshta dhe/ose sipas skenarëve me supozime të përcaktuara.

3. *Stress test*-et e realizuara nga banka përfshijnë të paktën përdorimin e skenarëve të veçantë dhe/ose të kombinuar,

bazuar në faktorë të tillë si: rënia ekonomike, ndryshimi i shpejtë i kushteve të tregut (ndryshe rreziku i tregut i përcaktuar nga luhatjet në kursin e këmbimit, normat e interesit etj.) me ndikim negativ në ndryshimin e aftësive për pagimin e rregullt të detyrimit (borxhit), apo edhe të skenarëve të një përkeqësimi të portofolit të kredive, pavarësisht nga përcaktimi i faktorit të rrezikut që mund të shërbejë si shkak për materializimin e një situate të pafavorshme.

4. Bankat përcaktojnë metodologjinë për realizimin e *stress test*-eve, supozimet e përdorura, si dhe veprimet në kundërpërgjigje të rezultateve të gjeneruara, ku përfshihen:

a) zbatimi, analiza e skenarëve të *stress test*-eve dhe periodiciteti i realizimit të tyre;
b) realizimi i *stress test*-eve për skenarë individualë dhe skenarë të kombinuar, në kushtet e ndodhjes së njëkohshme të disa skenarëve;
c) dokumentimi dhe rishikimi në mënyrë periodike i supozimeve të përdorura për kryerjen e *stress test*-eve;
d) forma dhe periodiciteti i raportimit të rezultateve të *stress test*-eve në strukturat drejtuese;
e) veprimet që duhet të ndërmerren nga strukturat drejtuese apo/dhe strukturat e veçanta të ngarkuara për administrimin e rrezikut të kredisë, mbështetur në rezultatet e *stress test*-eve.

KREU III
VLERËSIMI I KREDIVE DHE KRIJIMI I FONDEVE REZERVË PËR MBULIMIN E HUMBJEVE

Neni 11
Klasifikimi i kredive

1. Bankat, bazuar në kushtet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, bëjnë klasifikimin e kredisë të paktën një herë në 3 (tre) muaj, në një nga kategoritë e mëposhtme:

a) "standarde";
b) "në ndjekje";
c) "nënstandarde";
d) "të dyshimta";
e) "të humbura".

2. Bankat, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kredisë dhe gjendjen financiare të kredimarrësit, i klasifikojnë kreditë (duke përjashtuar kreditë kufi) si më poshtë:

a) "standarde", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset e pritshme hyrëse të parasë janë plotësisht të mjaftueshme për vazhdimësinë e veprimtarisë së tij dhe shlyerjen e detyrimeve,
ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 1 (një) deri 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

b) "në ndjekje", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset hyrëse të parasë janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet, pavarësisht vështirësive financiare të momentit, dhe se nuk ka shenja përkeqësimi të gjendjes së kredimarrësit për të ardhmen,
ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 31 (tridhjetë e një) deri 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

c) "nënstandarde", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e rregullt të detyrimeve të prapambetura, ose banka nuk disponon gjithë informacionin e kërkuar ose të përditësuar, të nevojshëm për të vlerësuar plotësisht gjendjen financiare të tij,
ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 91 (nëntëdhjetë e një) deri 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

d) "të dyshimta", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e plotë të detyrimeve, kredimarrësi shfaq probleme likuiditeti, dhe deklarimi i kredimarrësit "në paaftësi paguese/i falimentuar", vlerësohet si një mundësi reale,
ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 181 njëqind e tetëdhjetë e një) deri 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

e) "të humbura", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë se nuk siguron përmbushjen e plotë të kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit; ose vlerësohet se mungon i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e gjendjes financiare; ose kredimarrësi është në paaftësi paguese/ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi; ose kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë; ose banka ka vepruar juridikisht dhe në mënyrë përfundimtare (është marrë vendimi i formës së prerë të gjykatës) për të realizuar procesin e ekzekutimit të kolateralit,

ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej më shumë se 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së kështit.

3. Bankat, bëjnë klasifikimin e kredive kufi, si më poshtë:

a) "standarde", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset e pritshme hyrëse të parasë janë plotësisht të mjaftueshme për vazhdimësinë e veprimtarisë së tij dhe shlyerjen e detyrimeve,
ii. shuma e përdorur e kredisë është më e vogël ose e barabartë me shumën maksimale të miratuar,
iii. kredia është deri në 30 (tridhjetë) ditë vonesë nga afati fillestar i shlyerjes,

b) "në ndjekje", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset hyrëse të parasë janë plotësisht të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet, pavarësisht vështirësive financiare të momentit, dhe se nuk ka të shenja përkeqësimi të gjendjes së kredimarrësit për të ardhmen,
ii. shuma maksimale e miratuar e kredisë është tejkaluar për një periudhë nga 31(tridhjetë e një) deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë,
iii. afati përfundimtar i shlyerjes ka kaluar për një periudhë nga 31(tridhjetë e një) deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë,

c) "nënstandarde", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e rregullt të detyrimeve të prapambetura; ose banka nuk disponon të gjithë informacionin e kërkuar ose të përditësuar, të nevojshëm për të vlerësuar plotësisht gjendjen financiare të tij,
ii. shuma maksimale e miratuar e kredisë është tejkaluar për një periudhë nga 61 (gjashtëdhjetë e një) deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë,
iii. afati përfundimtar i shlyerjes ka kaluar për një periudhë nga 61 (gjashtëdhjetë e një) deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë,

d) "të dyshimta", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e plotë të detyrimeve, kredimarrësi shfaq probleme likuiditeti dhe deklarimi i kredimarrësit si "në paaftësi paguese/i falimentuar", vlerësohet si një mundësi reale;
ii. shuma maksimale e miratuar e kredisë është tejkaluar për një periudhë nga 91 (nëntëdhjetë e një) deri në 180 (njëqind e

tetëdhjetë) ditë;

iii. afati përfundimtar i shlyerjes ka kaluar për një periudhë nga 91 (nëntëdhjetë e një) deri në 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë;

e) "të humbura", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë se nuk siguron përmbushjen e plotë të kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit, ose vlerësohet se mungon i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e gjendjes financiare; ose kredimarrësi është në paaftësi paguese/ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi; ose kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë; ose banka ka vepruar juridikisht dhe në mënyrë përfundimtare (është marrë vendimi i formës së prerë të gjykatës) për të realizuar procesin e ekzekutimit të kolateralit,
ii. kufiri i miratuar është tejkaluar për një periudhë prej më shumë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh,
iii. afati përfundimtar i shlyerjes së kredisë ka kaluar për një periudhë prej më shumë se 180 (njëqindetetëdhjetë) ditësh;

4. Pavarësisht sa parashikohet në pikën 3 të këtij neni, bankat nuk mund të klasifikojnë kredinë kufi më lart se:

a) kategoria "në ndjekje", në rastin kur ka një vëllim qarkullimi, i cili nuk është në përputhje me ciklin e biznesit të parashikuar nga banka në analizën e saj, por shuma e kredisë qarkullon të paktën 1(një) herë në vit;
b) kategoria "nënstandarde", në rastin kur plotësohet të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme:

i. qarkullimet në llogari janë të vogla krahasuar me shumën e kredisë së përdorur dhe janë të pamjaftueshme për të justifikuar ecurinë normale të biznesit,
ii. kredia kufi ose një pjesë e rëndësishme e saj është përdorur për qëllime investimi afatgjatë.

5. Në rastin kur kushtet e klasifikimit të kredive, të përcaktuara në pikat 2 ose 3 të këtij neni, plotësohen për kategori të ndryshme të klasifikimit të kredisë, bankat klasifikojnë kredinë në kategorinë më të ulët.

6. Bankat, për persona ose grup personash të lidhur, për të cilët është regjistruar më shumë se një ekspozim, bëjnë klasifikimin e kredive në një kategori të vetme, duke u bazuar në klasifikimin më të ulët ndërmjet klasifikimeve individuale.

7. Bankat, në rastin e kredive të klasifikuara në kategoritë "nënstandard", "të dyshimta" dhe "të humbura", bëjnë riklasifikimin e një kredie në një kategori më të lartë, vetëm

në rastin kur, në bazë të analizave të dokumentuara, rezulton se justifikohet riklasifikimi. Dokumenti i analizës në rastin e riklasifikimit, ruhet në dosjen e kredisë.

8. Banka e Shqipërisë, ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e kategorisë së klasifikimit të kredive, në rastet kur gjykohet se:

a) interpretimi i kushteve të mësipërme nga banka nuk është i drejtë;
b) ka elemente të tjera shtesë, përveç kushteve të mësipërme, që e justifikojnë ndryshimin e kategorisë së klasifikimit.

Neni 12
Gjendja financiare e kredimarrësit

1. Bankat vlerësojnë dhe klasifikojnë kredimarrësit në bazë të gjendjes së tyre financiare.

2. Vlerësimi i gjendjes financiare të një kredimarrësi realizohet sipas kritereve të brendshme të përcaktuara nga banka, mbështetur në procedura të klasifikimit të kredimarrësve në kategori rreziku.

3. Bankat vlerësojnë gjendjen financiare të kredimarrësit sipas kritereve bazuar në të paktën, faktorët cilësorë dhe sasiorë të mëposhtëm:

a) statusi i kredimarrësit, karakteristika personale dhe ekonomike të tij;
b) cilësia e menaxhimit, përfshirë dhe atë të menaxhimit të nivelit të lartë të kredimarrësit, në rastet kur kredimarrësi është person juridik;
c) cilësia e aksionerëve, cilësia e planeve dhe programeve të mbështetura financiarisht nga banka;
d) niveli i kapitalit dhe rezervave të kredimarrësit dhe pjesa e tyre në bilancin e kredimarrësit;
e) cilësia e aktiveve të kredimarrësit;
f) madhësia e borxhit dhe aftësia për t'i shërbyer, si dhe historiku i ekspozimeve me bankën;
g) likuiditeti dhe përfitueshmëria;
h) *cash flow*-t (flukset e parave) e periudhave paraardhëse dhe *cash flow*-t (flukset e parave) e pritshëm, të krahasuar me detyrimet e kredimarrësit;
i) kushtet e biznesit dhe parashikimet e ardhshme për kredimarrësin, si dhe pozicioni i kredimarrësit në treg dhe në industrinë ku kryen veprimtarinë;
j) ekspozimi i kredimarrësit ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

4. Bankat, në vlerësimin e gjendjes financiare të kredimarrësit, mbështeten kryesisht në dokumentacionin e mëposhtëm:

a) bilanci (pasqyra e aktiv-pasivit dhe zërave jashtë bilancit);
b) llogaria fitim-humbje;
c) vërtetimi i pagës për individët, si dhe deklarata e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre, e dokumentuar për të ardhurat dhe shpenzimet materiale;
d) pasqyra e detyrimeve mbi kreditë dhe interesat për t'u paguar;
e) pasqyra mbi ndryshimet në kapital;
f) pasqyra e *cash flow*-t;
g) raportet e ekspertit kontabël mbi gjendjen financiare të kredimarrësit;
h) raporte të agjencive të vlerësimit.

5. Periudhat për të cilat vlerësohet gjendja financiare e kredimarrësit duhet të përputhet të paktën me periudhat e nxjerrjes së pasqyrave financiare.

Neni 13
Ristrukturimi i kredisë

1. Bankat, në marrëveshje me kredimarrësin, mund të ristrukturojnë kredinë, sipas kritereve të përcaktuara në manualin e kredisë, të miratuar nga organet drejtuese. Ristrukturimi i kredisë mund të kryhet dhe kur, mbështetur në analizat e tyre, bankat gjykojnë se në të ardhmen gjendja financiare e kredimarrësit do të përmirësohet ndjeshëm, ose të ardhurat nga veprimtaria e tij do të rriten në mënyrë të konsiderueshme dhe se kredimarrësi do ta paguajë (shlyejë) të gjithë kredinë sipas kushteve të reja.

2. Kredia e ristrukturuar, nuk mund të klasifikohet më lart se një kategori nga kategoria në të cilën është klasifikuar përpara ristrukturimit dhe, në çdo rast, jo më lart se kategoria "nënstandard", deri në plotësimin njëkohësisht të kushteve të mëposhtme:

a) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt kështet (kryegjë dhe interes) për një periudhë prej 9 (nëntë) muajsh nga data e ristrukturimit;
b) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt të paktën 3 (tre) këste (kryegjë dhe interes).

3. Kredia e ristrukturuar, me plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, klasifikohet duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 14
Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë

1. Në varësi të kategorive të klasifikimit, bankat krijojnë fondet përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë.

2. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen si më poshtë:

a) për kategorinë "standarde".....1 (një) për qind;
b) për kategorinë "në ndjekje".....5 (pesë) për qind;
c) për kategorinë "nënstandarde".....jo më pak se 20 (njëzet) për qind;
d) për kategorinë "e dyshimtë".....jo më pak se 50 (pesëdhjetë) për qind;
e) për kategorinë "e humbur".....100 (njëqind) për qind.

3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, për dy kategoritë e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 2 të këtij neni, do të aplikohet njëlloj si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kredinë me probleme, norma e aplikuar mbi interesin e përllogaritur do të jetë 100% (njëqind për qind) për çdo kategori.

4. Bankat, në llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, mund të përdorin teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë të përcaktuara në Kreun IV të kësaj rregulloreje me qëllim zvogëlimin e ekspozimit përpara aplikimit të normave të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 15
Vlerësimi i kredisë së ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

1. Banka, si pjesë të rëndësishme të strategjisë, të politikave, të procedurave dhe të rregullave të brendshme për monitorimin dhe kontrollin në vazhdimësi të cilësisë së portofolit të kredisë, përfshin në veçanti dhe trajtimin e portofolit/eve të ekspozuara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

2. Banka ponderon me koeficient më të lartë rreziku, për efekt të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, vlerën e kredisë në valutë dhe/ose të indeksuar në valutë të ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, siç përcaktohet në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit".

3. Totali i kredive të bankës në valutë dhe/ose të indeksuara në valutë të ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, nuk duhet të kalojë 400 për qind të kapitalit rregullator të saj në baza individuale dhe të konsoliduara. Çdo shumë që tejkalon këtë kufi do të zbritet nga kapitali rregullator i bankës për efekt të llogaritjes së raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Neni 16
Kontabilizimi i interesave

1. Bankat, për kreditë të cilat janë të pashlyera për më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë, si edhe për kreditë e klasifikuara në kategorinë "të dyshimta" ose në kategorinë "të humbura", nuk

kontabilizojnë interesat e llogaritur.

2. Në rastet kur kredimarrësi shlyen detyrimin, në llogaritjen e detyrimit përfshihen edhe interesat e pakontabilizuara.

Neni 17
Fshirja e kredive të humbura

1. Fshirja e kredive të humbura bëhet me vendim të Këshillit Drejtues të bankës ose organit kompetent të bankës mëmë, në rastin e degës së bankës së huaj, si dhe në çdo rast kur Banka e Shqipërisë ka vlerësuar dhe kërkuar fshirjen e saj.

2. Dosjet e kredive të fshira, ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në 6 (gjashtë) muaj nga Këshilli Drejtues i bankës. Çdo arkëtim nga këto kredi të fshira, konsiderohet si e ardhur e jashtëzakonshme.

KREU IV
TEKNIKAT E ZBUTJES SË RREZIKUT TË KREDISË

Neni 18
Zbutja e rrezikut të kredisë me anë të garancive dhe kolateraleve financiare

Bankat, me qëllim llogaritjen e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, mund të përdorin vlerën e garancive dhe kolateraleve financiare të përcaktuara në këtë rregullore, për të zvogëluar ekspozimin e tyre nga kreditë.

Neni 19
Garancitë e pranuara

1. Bankat, për zbutjen e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë, mund të pranojnë garancitë e përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje, të cilat plotësojnë karakteristikat e mëposhtme:

i. garancia është e lidhur në mënyrë të qartë me ekspozime ose me një portofol ekspozimesh që mund të identifikohen me saktësi, në mënyrë që shkalla e mbulimit të jetë e përcaktuar qartë dhe të mos vihet në dyshim,
ii. kontrata (marrëveshja) e garancisë nuk përmban asnjë dispozitë që mund të lejojë ofruesin e garancisë të anulojë në mënyrë të njëanshme kontratën e garancisë ose të rrisë koston efektive të saj (garancisë),
iii. kontrata e garancisë nuk përmban asnjë dispozitë që përjashton garantuesin nga detyrimi për të paguar brenda afatit të përcaktuar në kontratën e garancisë, në rastin kur kredimarrësi kryesor nuk

paguan detyrimin sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në kontratën e kredisë;

2. Garancitë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni do të përdoren për qëllime të zbutjes/zvogëlimit të rrezikut të kredisë, vetëm kur plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) janë ligjërisht të sigurta (domethënë, janë përmbushur të gjitha detyrimet/formalitetet ligjore për lëshimin e garancisë) dhe banka disponon dokumentacionin e nevojshëm për ekzekutim;
b) mbulojnë të gjitha llojet e pagesave që kredimarrësi është i detyruar të kryejë, lidhur me detyrimin e tij. Në rastin kur kontrata e garancisë/ve përjashton disa lloje pagesash nga mbulimi, banka, për qëllime të zbatimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, njeh vlerën e garancisë vetëm për shumat që i takojnë llojeve të pagesave që mbulon kjo garanci;
c) banka disponon procedurat dhe sistemet e nevojshme për monitorimin periodik dhe kontrollin e rreziqeve që mund të vijnë nga përdorimi i garancive si teknikë zbutjeje.

Neni 20
Kolateralet financiare

1. Bankat, për zbutjen e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë, marrin në konsideratë kolateralet financiare të përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

2. Kolateralet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, do të përdoren për qëllime të zbutjes/zvogëlimit të rrezikut të kredisë, vetëm kur plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) gjendja financiare e kredimarrësit dhe vlera e kolateralit nuk kanë një lidhje/korrelacion pozitiv material (domethënë, titujt e emetuar nga kredimarrësi ose persona të lidhur me të nuk do të konsiderohen si kolaterale të pranueshme për zbutjen e rrezikut të kredisë);
b) janë ligjërisht të sigurta (domethënë, janë përmbushur të gjitha detyrimet ligjore për vendosjen si kolateral) dhe banka ose dega e bankës së huaj disponon dokumentacionin e nevojshëm për ekzekutim;
c) banka disponon procedurat dhe sistemet e nevojshme për monitorimin periodik dhe kontrollin e rreziqeve që mund vijnë nga përdorimi i kolateraleve financiare si teknikë zbutjeje.

3. Bankat llogarisin vlerën e tregut të kolateraleve të pranuara, të paktën një herë në 6 (gjashtë) muaj dhe në çdo rast, kur besojnë se ka një rënie të ndjeshme në vlerën e tregut.

Neni 21
Mënyrat e përdorimit të garancive dhe kolateraleve financiare
për zbutjen e rrezikut të kredisë

1. Bankat, për përcaktimin e vlerës me të cilën do të zbusin ekspozimin kundrejt kredimarrësit, korrigjojnë vlerën e garancive të pranuara dhe të kolateraleve financiare me koeficientët "K", të llogaritur sipas formulës së përcaktuar në Aneksin 2, të kësaj rregulloreje.

2. Banka nuk mund të përdorë garancitë dhe kolateralet financiare për zbutjen e rrezikut të kredisë, në rastin kur:

a) maturiteti i mbetur i mbrojtjes së kredisë është më i vogël se 3 (tre) muaj dhe kredia ka një maturitet të mbetur më të madh se maturiteti i mbetur i mbrojtjes;
b) maturiteti fillestar i mbrojtjes së kredisë është më i vogël se një vit dhe maturiteti i mbetur i kredisë është më i madh se maturiteti fillestar i mbrojtjes.

3. Vlera e koeficientit "K", në rastin e garancive dhe kolateraleve financiare të lidhura me kreditë e klasifikuara në kategorinë "të humbura" zvogëlohet në masën 50 (pesëdhjetë) për qind të vlerës së llogaritur sipas Aneksit nr. 2 të kësaj rregulloreje.

KREU V
VLERËSIMI I AKTIVEVE TË TJERA DHE PËRCAKTIMI I FONDEVE
REZERVË PËR MBULIMIN E HUMBJEVE

Neni 22
Vlerësimi i aktiveve të tjera

1. Bankat, të paktën një herë në çdo 3 (tre) muaj dhe në rastet kur ekzistojnë të dhëna që tregojnë se cilësia e çdo aktivi tjetër është përkeqësuar në mënyrë thelbësore, bën rishikimin e vlerësimit të tyre sipas përcaktimeve në standardet e kontabilitetit.

2. Bankat vlerësojnë në mënyrë individuale të gjitha aktivet e tjera, individualisht të rëndësishme.

3. Bankat vlerësojnë pjesën tjetër të aktiveve të tjera, në mënyrë individuale ose në mënyrë kolektive, duke i grupuar sipas karakteristikave të njëjta.

4. Bankat, për evidentimin e aktiveve individualisht të rëndësishme, bazohen në madhësinë relative të tyre ndaj totalit të aktivit, të kapitalit rregullator, si dhe në informacionin cilësor si pjesë e një grupi të caktuar aktivesh.

Neni 23
Klasifikimi i aktiveve të tjera dhe përcaktimi i fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve

1. Bankat, bazuar në madhësinë e humbjeve të llogaritura sipas standardeve të kontabilitetit, klasifikojnë aktivet e tjera si më poshtë:

a) "standarde ose të rregullta", kur madhësia e humbjeve të llogaritura është deri në 5% (pesë për qind) të ekspozimit;
b) "të dyshimta ose me probleme", kur madhësia e humbjeve të llogaritura është më e madhe se 5% (pesë për qind) e ekspozimit.

2. Bankat krijojnë fonde rezervë për mbulimin në mënyrë të plotë të humbjeve nga zhvlerësimi i aktiveve të tjera.

KREU VI
RAPORTIMI DHE MBIKËQYRJA

Neni 24
Raportimi në Bankën e Shqipërisë

Bankat raportojnë në Bankën e Shqipërisë klasifikimin e kredive dhe aktiveve të tjera që krijojnë rrezikun e kredisë, si dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin nga humbjet prej tyre, sipas kërkesave të përcaktuara në "Sistemin Raportues të Unifikuar".

Neni 25
Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat.

Neni 26
Dispozitë e fundit

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI

ANEKSI 1
GARANCITË DHE KOLATERALET E PRANUESHME

Lloji i garancisë ose kolateralit	Koeficienti maksimal (k)
Garancitë	
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ose të Bankës së Shqipërisë, në monedhë kombëtare	1
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të qeverive qendrore ose bankave qendrore të vendeve të OECD ose të Komunitetit Evropian	1
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të bankave shumëpalëshe të zhvillimit ose te Bankës Evropiane të Investimeve	0.8
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të organeve të pushtetit vendor të Republikës së Shqipërisë	0.8
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të bankave ose degëve të bankave të huaja, të licencuara për të ushtruar aktivitet në Republikën e Shqipërisë	0.8
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të administratave rajonale ose lokale të vendeve të OECD-së	0.8
Garanci të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara të bankave nga vendet e OECD-së	0.8
Kolaterale financiare	
Tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose nga Banka e Shqipërisë në monedhë kombëtare	1
Tituj të emetuar nga qeveritë qendrore ose bankat qendrore të vendeve të OECD ose të Komunitetit Evropian	1
Depozita monetare të vendosura si kolateral pranë bankës ose degës së bankës së huaj	1
Certifikata depozite ose instrumente të ngjashme, të emetuara nga banka ose dega e bankës së huaj dhe të vendosura si kolateral pranë saj	1
Tituj të emetuar nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit ose nga Banka Evropiane e Investimeve	0.8

ANEKSI 2

Llogaritja e koeficientit *"K"* me të cilin do të korrigjohet vlera e kolateraleve financiare dhe garancive të pranuara.

ku: $K = (k - k_{FX}) \times \frac{(t - 0.25)}{(T - 0.25)}$,

(k) është koeficienti i përcaktuar në aneksin 1;

(k_{FX}) është koeficienti që shërben për korrigjimin e vlerës së garancisë ose kolateralit, për efekt të rrezikut të kursit të këmbimit, i cili:

- në rastin kur garancitë dhe/ose kolateralet financiare janë të emetuara në të njëjtën monedhë me ekspozimin e bankës kundrejt kredimarrësit, merr vlerën 0 $(k_{FX} = 0)$ ose
- në rastin kur garancitë dhe/ose kolateralet financiare janë të emetuara në një monedhë të ndryshme, ekspozimi i bankës kundrejt kredimarrësit merr vlerën 0.08 $(k_{FX} = 0.08)$;

(t) është maturiteti i mbrojtjes së kredisë, i shprehur në vite, i cili është i barabartë me vlerën më të vogël ndërmjet numrit të viteve të mbetura deri në datën e maturimit të mbrojtjes së kredisë dhe vlerës së (T);

(T) është maturiteti efektiv i kredisë, i shprehur në vite, i cili është i barabartë me vlerën më të vogël ndërmjet numrit të viteve të mbetur deri në datën e maturimit të kredisë dhe vlerës 5 vjet.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 63, datë 14.09.2011

PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
"PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; dhe të nenit 59, pika 3 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" miratuar me vendimin nr. 58, datë 05.05.1999 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

   a) Neni 8, pika 8.1.5, shkronja "a" ndryshon si më poshtë:

   "…vlera e kredisë në valutë dhe/ose të indeksuar në valutë për kredimarrësin që plotëson njëkohësisht kushtet e përcaktuara në nenin 4, pika 2, shkronja "c" të rregullores "Për administrimin e rrezikut të kredisë" dhe karakteristikat e përcaktuara në pikën 8.1.4 shkronja "f", të kësaj rregulloreje…"

   b) Neni 8, pika 8.1.5, shkronja "b" ndryshon si më poshtë:

   "…vlera e kredisë së akorduar jashtë territorit ku banka ushtron veprimtarinë nëpërmjet filialeve, degëve ose agjencive të saj…"

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit

Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI	KRYETARI
YLLI MEMISHA	ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 67, datë 14.09.2011

PËR
EMËRIMIN E DREJTORIT TË DEPARTAMENTIT TË EMISIONIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "h" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; nenit 18 të rregullores "Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendimin nr 21, datë 16.05.2007 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 79, datë 31.10.2005 "Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë" i ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të emërojë në funksionin e Drejtorit të Departamentit të Emisionit të Bankës së Shqipërisë, zotin Dorian Çollaku.

2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI — KRYETARI

YLLI MEMISHA — ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 68, datë 29.09.2011

PËR
ULJEN E NORMËS SË INTERESIT TË MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES
DHE TË ANASJELLTA TË RIBLERJES

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë uljen me 0.25 pikë përqindjeje të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (repo dhe repo të anasjellta). Norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (nga 5.25 për qind që është) bëhet 5.00 për qind.

2. Ngarkohen Departamenti i Politikës Monetare dhe Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi në datën 30.09.2011.

SEKRETARI — KRYETARI

YLLI MEMISHA — ARDIAN FULLANI

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 13, NUMËR 1, JANAR 2011

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 03, datë 19.01.2011 "Për miratimin e rregullores "Për administrimin e rrezikut operacional"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 04, datë 19.01.2011 "Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 06, datë 26.01.2011 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 13, NUMËR 2, SHKURT 2011

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 10, datë 23.02.2011 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 23.02.2011 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit të Bankës së Shqipërisë".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 23.02.2011 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloret "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS" dhe "Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)"".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 13, NUMËR 3, MARS 2011

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 13, datë 09.03.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individët"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 09.03.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare"".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 17, datë 09.03.2011 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë e informacionit"".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 18, datë 09.03.2011 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 25.10.2006 për "Politikën e sigurisë së informacionit"".
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 21, datë 23.03.2011 "Për rritjen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes".
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 23, datë 23.03.2011 "Për një ndryshim në "Sistemin raportues të unifikuar për bankat"".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 13, NUMËR 4, PRILL 2011

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 27, datë 27.04.2011 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 28, datë 27.04.2011 "Për miratimin e normës së interesit për remunerimin e rezervës së detyruar të subjekteve bankare".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 27.04.2011 "Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi minimumin e rezervës së detyruar të mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat"".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 30, datë 27.04.2011 "Për miratimin e rregullores "Për fondin e pensionit suplementar të Bankës së Shqipërisë"".
5. Urdhër i Zëvendësguvernatorit të Parë nr. prot. 3652, datë 29.04.2011 "Për miratimin e shtesës së një veprimtarie financiare në licencën e subjektit financiar jobankë AK-INVEST Sh.a".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 13, NUMËR 5, MAJ 2011

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 33, datë 11.05.2011 "Për një shtesë në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 34, datë 11.05.2011 "Për dhënien e miratimit paraprak për rritjen e përqindjes të pjesëmarrjes influencuese të z. Renis Tërshana në kapitalin aksioner të Bankës Credins sh.a".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 35, datë 11.05.2011 "Mbi dhënien e miratimit për realizimin e objektit të prokurimit "Shërbime të kontrollorit të jashtëm për llogaritë dhe raportet financiare të Bankës së Shqipërisë", nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje trevjeçare".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 37, datë 25.05.2011 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes".
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 39 datë 25.05.2011 "Për miratimin e rregullores "Për eksport–importet e kartëmonedhave e të monedhave metalike shqiptare"".
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 40, datë 25.05.2011 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 27, datë 30.03.2005 "Për shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, për vitin 2006"".
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 41, datë 25.05.2011 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 12.10.2005 "Për miratimin e përmbajtjes dhe konfigurimeve të

vizatimeve të monedhës që do të shtypet për qëllime numizmatike në vitin 2006".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 13, NUMËR 6, QERSHOR 2011

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 32, datë 15.06.2011 "Për miratimin e rregullores "Për ekspertin kontabël të autorizuar të bankave dhe degëve të bankave të huaja"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 43, datë 15.06.2011 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka"".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 44, datë 15.06.2011 "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Tirana sh.a".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 47, datë 29.06.2011 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes"".
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 48 datë 29.06.2011 "Për rishtypjen e kartëmonedhës shqiptare me kurs ligjor, me prerje 1000 lekë"".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 13, NUMËR 7, KORRIK 2011

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 50, datë 13.07.2011 "Për shtypjen e monedhave shqiptare për qëllime numizmatike, në vitin 2012".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 53, datë 27.07.2011 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 55, datë 27.07.2011 "Për miratimin procedurës së veçantë të prokurimit për realizimin e projektzbatimit të rikonstruksionit të ndërtesës së ish-Hotel "Dajti"".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 27.07.2011 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit të Bankës së Shqipërisë".

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Avni Rustemi", nr. 24, Tiranë
Tel : + 355 4 241 93 01 / 02 / 03; + 355 4 241 94 09/10/11
Faks: + 355 4 241 94 08
www.bankofalbania.org
E-mail: public@bankofalbania.org
Tirazhi: 350 kopje
shtypur në shtypshkronjën "AdelPrint" sh.p.k.